

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
“BAJRAM ALLARAJ”, TË BASHKISË SË TIRANËS**

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Bajram Allaraj”, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, për sipërfaqen prej 300 (treqind) m² truall, në vlerën 10 859 100 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e njëqind) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 10 859 100 (dhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e njëqind) lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit në Bashkinë e Tiranës të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 300 (treqind) m² truall për ndërtimin e rrugës të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
 9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lista emërore e pronarëve, pasuritë e të cilëve do të shpronësohen për ndërtimin e rrugës së "Bajram Allaraj"

NR.	EMËR MBIEMËR	Z.KADAS.	NR.PAS.	Tr.Pergj./m²	Tr.prek. /m²	ÇMIMI /m²	VLEFTA
1	Bashkëpronaret HYKA	8190	3/252	4550	300	36197	10.859.100
						Shuma	10.859.100